



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_/2017

**PËR**

**NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 10316, DATË 16.9.2010 “PËR  
DISA SHITESA NË LIGJIN NR.7764, DATË 02.11.1993 “PËR INVESTIMET E HUAJA””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 10316, datë 16.9.2010 “Për disa shtesa në ligjin nr.7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”, bëhet një ndryshim dhe një shtesë si më poshtë vijon :

**Neni 1**

Në nenin 3 “Dispozitë kalimtare”, bëhet një ndryshim dhe një shtesë si më poshtë :

1. Fjalët "31 Dhjetor 2014" zëvendësohen me fjalët "31 Dhjetor 2018".
2. Pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Mbrojtje të posaçme shtetërore sipas parashikimeve të neneve 8/b, pikave 1 dhe 2; 8/d dhe 8/dh të këtij ligji, përfitojnë automatikisht dhe pa patur nevojën e ndjekjes se ndonjë procedure apo marrjes se ndonjë vendimi tjetër, edhe investitorët/investimet strategjike, procedurë e veçantë që kanë marrë këtë status në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Këshilli i Ministrave, përcakton kufijtë dhe tagrat e zëvendësimit te palëve, ne përputhje me nenin 8/b te këtij ligji.

**Neni 2**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I KUVENDIT**

**ILIR META**